

30 VITE PRANI E ETËRVE ORIONINË NË SHQIPËRI

12 nëntor 2022

Me kënaqësi i kujtoj këto tridhjetë vitet e fundit për të rindërtuar praninë e Bijve të Provanisë Hyjnore në Shqipëri: një emër që nuk është vetëm një program jete dhe mision i Bijve të Shën Luigji Orionit, por edhe realizim i projektit provanor të Hyjit për këtë tokë.

E gjitha filloi me apelin për të ndihmuar ngritjen e popullit dhe të Kishës në Shqipëri nëpërmjet dërgimit misionar, nisur nga Papa Shën Gjon Pali II, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, Nuncit Apostolik Ivan Dias. Ai ishte i bindur se prania misionare do të favorizonte si zhvillimin e territorit, ashtu edhe rilindjen e Kishave vendore.

Ndër objektivat që ishin vënë, para së gjithash ishte rritja e pranisë së Kishës Katolike, riungjillëzimi i katolikëve ende të pranishëm në Shqipëri, rindërtimi ose ndërtimi nga e para e objekteve të kultit dhe e qendrave baritore të shkatërruara nga komunizmi dhe përkujdesja që i duhej kushtuar kujdesit baritor të shqiptarëve në gjendje migrimi.

Me rënien e diktaturës, në veri të Shqipërisë filluan të vepronin më aktivisht ata pak priftërinj dioqezanë që kishin mbetur, si edhe françeskanët, jezuitët, murgeshat stigmatine, salezianët dhe salezianet. Mesha e Parë pas komunizmit ishte kremtuar tashmë në Shkodër, në varrezat katolike të Rrmajve, më 4 nëntor 1990, më pas një tjetër më 11 nëntor, me një prani shumë të madhe të besimtarëve: katolikë, ortodoksë dhe myslimanë, Meshë kjo që u pasua me marrjen e Xhamisë së Plumbit nga ana e myslimanëve, më 16 nëntor. Në këtë mënyrë, domethënë nëpërmjet rifitimit të besimeve të tyre, populli shfaqte vullnesën e tij për të rifituar lirinë e vet të shprehjes edhe në të gjitha fushat e jetës civile në vend.

Apeli i Papës u mirëprit bujarisht nga kongregata të shumta rregulltare mashkullore dhe femërore, të cilat, duke iu referuar Nuncit Apostolik, i cili, përpara rithemelimit të Hierarkisë kishtare, ishte i vetmi person përgjegjës i Kishës Katolike, dhe me propozimin e tij u caktuan vendet e misionit.

Kështu, në vitin 1992 jugu i Shqipërisë u pajis me praninë në Elbasan të Orioninëve, të Motrave të Shenjtes Gjovana Antida, të Motrave Domenikane, të Motrave të Nënë Terezës së Kalkutës; ndërsa në Vlorë mbërriti Kongregata Servite, me dy degët e saj mashkullore dhe femërore.

Në realitet, ai i Etërve Orionine që një rikthim në Shqipëri, pasi, para Luftës së Dytë Botërore, ata ishin të pranishëm në zonën e Bushatit (Shkodër); që nga viti 1998 ata duke qenë të pranishëm edhe në Shirokë (Anë dhe Malit-Shkodër) dhe në Bardhaj.

Ndërkohë, më 25 prill 1993, Gjon Pali II vendosi të vinte në Shqipëri ku shuguroi katër Ipeshkvijtë e Parë (Imzot Frano Illinë, Imzot Zef Simonin, Imzot Rrok Mirditën dhe Imzot Robert Ashtës) duke rithemeluar kështu Hierarkinë kishtare të pas komunizmit. Prandaj, me mbërritjen time në Shqipëri në gusht të vitit 1993, për të qëndruar përgjithmonë si misionar dhe Mësues i novicëve françeskanë në Lezhë, gjeta të shuguruar Arqipeshkvin e Shkodrës Imzot Frano Illinë, të cilin e kisha njohur dhe të cilit i kisha shërbyer duke filluar nga dhjetori i vitit 1991, kur erdha për herë të parë në Shqipëri, dhe në korrik-gusht të vitit 1992 kur qëndrova dy muaj në Laç të Kurbinit, duke kremtuar Meshën e shenjtë të dielën në Milot, ku ishte famullitar Dom Franoja, i cili në atë periudhë shkoi për t'u mjekuar në Itali.

Udhëtimi apostolik i Shën Gjon Palit II, 21 vjet më vonë, u pasua nga ai i Papa Françeskut, më 21 shtator 2014, i cili i ftoi katolikët shqiptarë që të fluturojnë lart dhe të kujdesen për foletë siç bëjnë shqiponjat. Ai, pas vizitës *ad limina* të vitit 2017, emëroi tre Ipeshkvij të tjerë: Imzot Peragine-n, Imzot Metën dhe Imzot Kullin.

Në atë periudhë kohe ndërmjet vizitës së dy papëve u ndie nevoja e një angazhimi të fuqishëm për rindërtimin e njeriut, të shoqërisë dhe të mbarë kombit shqiptar. Në fakt, ai sapo kishte dalë nga fatkeqësia njerëzore, kulturore, ekonomike dhe fetare e dekretuar me shpalljen e Shqipërisë si *shteti i vetëm ateist në botë* në vitin 1975, dhe realizuar *de facto* më 6 shkurt 1967, duke nxjerrë jashtë

ligjit besimet fetare tradicionale: atë të krishterë (katolik, ortodoks dhe ungjillor) dhe atë mysliman (sunit dhe bektashi).

Prania e misionarëve, në bashkëpunim me priftërinjtë shqiptarë të mbijetuar nga komunizmi, ishte dhe është një shenjë shprese e madhe për popullin shqiptar. Por disa gjëra nuk kanë ndryshuar. Për shembull, edhe pse për arsye të ndryshme, eksodi masiv i të rinjve dhe i familjeve të tëra vazhdon ende sot; një eksod me përmasa “biblike”, që po varfëron tragjikisht vendin tonë, duke e bërë atë të plakët në mënyrë të pashmangshme deri në atë pikë sa të bëhet thujse e pamundur për sipërmarrësit të gjejnë fuqi punëtore.

Në këto 30 vjet kemi shpresuar në një rritje të fortë ekonomike, kulturore dhe sociale dhe në realitet janë bërë shumë hapa në shoqëri dhe në Kishë, si edhe në marrëdhëniet ekumenike dhe ndërfetare. Megjithatë, nuk ka ndodhur një evolucion politik të tillë që t'u ofrojë siguri në sferën ekonomike dhe drejtësisë shumë familjeve që nuk shohin rrugëdalje tjetër përveç migrimit. Mjerisht, mendja ime shkon te shumë të moshuar që tashmë kanë mbetur vetëm! Mjafton të kujtojmë faktin se në vitin 1991 Shqipëria mburrej si kombi më i ri në Europë, ndërsa sot është një komb me emergjencë për të moshuarit!

Nuk ka mjaftuar as angazhimi i jashtëzakonshëm i Caritas-it kombëtar, si edhe i atyre dioqezanë e famullitarë, ashtu si edhe i të gjithë priftërinjve dhe rregulltarëve/misionarëve në këto tridhjetë vjet: varfëria ekziston ende në shumë shtresa të popullsisë, ndërsa rritet numri i të pasurve, duke vënë kështu në dukje një padrejtësi të fortë sociale, që krijon një humnerë të madhe mes njerëzve.

Edhe sektori i shëndetësisë ka bërë përparime të mëdha, por korrupsioni dhe varfëria e një pjese të madhe të popullsisë i pengon të varfërit të marrin kujdes mjekësor dhe shëndetësor në institucionet shëndetësore, pasi kostoja e mjekimit në klinikat private nuk përballohet prej tyre, por edhe mjekimi në institucionet publike ndonjëherë të detyron të bëhen bashkëpunëtorë në sjellje jokorrekte, për shkak të korrupsionit! Një falenderim i madh i shkon sistemit shëndetësor italian, i cili ka mirëpritur qindra të sëmurë dhe fëmijë, që janë mjekuar falas dhe janë ndihmuar nga Caritas-et e ndryshme italiane apo shoqatat bamirëse.

Por hapi cilësor mbetet ende për t'u bërë. Në fakt, është e nevojshme të kalojmë nga një Caritas i kuptuar si asistencializëm në një Caritas të aftë për t'i bërë zemrat bamirëse, një Caritas intelektual, siç e përkufizonte i Lumi Antonio Rosmini; një Caritas që synon t'i bëjë zemrat e shqiptarëve t'u drejtohen vëllezërve shqiptarë në vështirësi. Dhe kjo duke u nisur nga strukturat qeveritare! E kam përsëritur shpesh në ndërhyrjet e mia: “Shqiptari duhet ta ndihmojë vëllanë e vet shqiptar”, “Shqiptari duhet të jetë i mëshirshëm ndaj vëllait të vet shqiptar”.

Kisha Katolike dhe, në veçanti, ne meshtarët dhe rregulltarët, duhet të vazhdojmë të jemi të pranishëm “me” dhe “në mes” të njerëzve, duke respektuar të tjerët, besimet e tjera fetare dhe duke shpallur Ungjillin “me parrez”.

Fillimet e viteve '90 i kam quajtur si "**vitet heroike të misionit**" në Shqipëri: ishim mes njerëzve, si p.sh. kur në vitin 1997, "viti i çmendurisë kombëtare", ne krerët e besimeve fetare e shpëtuam Shqipërinë nga një fatkeqësi më e madhe se ajo e shkaktuar nga shpërbërja e Shtetit dhe revolta e armatosur e popullit.

Sigurisht, fillimet e misionit nuk qenë të thjeshta, meqë duhej të përballeshim me një realitet të ri që kërkonte aftësi të mira në inkulturim; pastaj, mësimi i gjuhës shqipe dhe shoshitja e vështirë nëse duhej të mësonim gjuhën zyrtare shqipe apo atë që flisnin njerëzit; mungesa e infrastrukturës, rrugët e këqija ose inekzistente, energjia elektrike që mungonte pjesën më të madhe të ditës dhe të natës apo tensioni i ulët që nuk të lejonte as të gatujesh; vështirësitë e furnizimit me ujë dhe me ushqime. Megjithatë, këto vështirësi nuk e ulën gëzimin dhe entuziazmin e misionarëve, të cilët u shpërblyen me gëzimin dhe harenë e besimtarëve, të cilëve ata u shërbenin.

Kanë qenë kohë rindërtimi të shtëpive për të jetuar dhe të vendeve të kultit, por mbi të gjitha kohë rindërtimi të njerëzve që diktatura komuniste u kishte vjedhur shpirtin, siç thoshte dikush. Ishte gjithashtu kohë kur ne u treguam burra e gra solidarë, siç kam pasur rastin të tregoj në librin e kujtimeve të mikpritjes së kosovarëve në vitin 1999 kur ata u dëbuan nga serbët.

Tani është koha që të gjithë të ndihemi përgjegjës për një Shqipëri më të mirë, veçanërisht në këtë moment në të cilin ka nisur zyrtarisht procesi i hyrjes në Bashkimin Evropian. Por nuk

duhet të hyjmë duke paguar çmimin e humbjes së identitetit tonë, duke iu nënshtruar politikave sociale dhe ekonomike që nuk përkojnë me traditën tonë; përkundrazi, kemi për detyrë t'i ofrojmë Evropës pasurinë e dëshmisë sonë, domethënë të tregojmë se si është e mundur të jetojmë së bashku pavarësisht dallimeve në besime fetare, kulturë dhe traditë.

Dhe ne katolikët kemi një detyrë të mëtejshme për të hyrë në Bashkimin Evropian: atë që të ndajmë me vëllezërit dhe motrat e tjera të besimit katolik nevojat për të cilat po na thërret Sinodi: Bashkësi (*bashkim*), Pjesëmarrje (*pjesëmarrje dhe bashkëpërgjegjësi*) dhe Mision (*mision*).

Në këtë mënyrë nuk do ta humbasim identitetin tonë, por do ta rifitojmë pikërisht duke u nisur nga mandati misionar që na besoi Jezusi: “*Shkoni, predikoni dhe pagëzoni në emër të Atit, të Birit dhe të Shpirtit Shenjt*”, duke dëshmuar besimin tonë në Krishtin, Shpëtimtarin e vetëm, krenarë që kemi mes Shenjtërve tanë Nënë Terezën që na udhëzon me shembullin e jetës së saj për t'u solidarizuar me më të varfërit e të varfërve, me Martirët tanë të Lumë, e mes tyre veçanërisht (meqë jemi në Elbasan) të Lumët Atë Josif Papamihali dhe Mons. Jul Bonati, të cilët kanë vuajtur në kampet e ndryshme të punës së detyruar dhe të përqendrimit, ose në Kampin e shfarosjes në Tepelenë.

E përfundoj duke falënderuar të gjithë Etërit Orioninë, që pasuan njëri-tjetrin në këtë mision, edhe ata që erdhën për ta përjetuar misionin në Shqipëri vetëm për pak kohë.

Faleminderit edhe të gjithë ju, besimtarë të Elbasanit dhe të fshatrave ku kanë shërbyer dhe ku shërbejnë ende Etërit Orioninë, dhe të gjithë ju bashkëpunëtorë.

Faleminderit Kardinalit Ivan Dias, Nuncit në Shqipëri dhe Administratorit Apostolik të Shqipërisë së Jugut, Imzot Hil Kabashit, shuguruar me mua më 6 janar 1997 në Shën Pjetër në Romë nga Shën Gjon Pali II.

Faleminderit Imzot Giovanni Peragine, Administrator aktual Apostolik i Shqipërisë së Jugut.

Nëna e Këshillit të Mirë, Pajtorja e Shqipërisë, Shenjtja Terezë e Kalkutës dhe 38 Martirët e Lumë, Imzot Vinçenc Prennushi me shokë, na ndihmofshin që të jemi gurë të gjallë dhe besimtarë aktivë për ta ndërtuar Kishën tonë, edhe me dhuntinë e thirrjeve të tjera, për të cilat kemi nevojë të madhe, dhe për të qenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm për Shqipërinë tonë.

Faleminderit

† **Angelo Massafra O.F.M.**
Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult
President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë